

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ, departamenti I eprgjitshem-divizioni civil, gjyqtari Enes Mehmeti dhe procesmbajtesja minire Krasniqi, ne ceshtjen juridiko-kontestimore te inicuar me padine e paditeses [REDACTED] me seli ne Prishtine, rr" [REDACTED], kunder te paditurit [REDACTED] nga Shtimja rr" [REDACTED] per rimbursim demi, jashte seance me date 19.02.2015, merr ket:

A K T G J Y K I M

-PER SHKAK TE PADEGJUESHMERISE/MOSBINDJES-

APROVOHET kerkesepadia e paditeses [REDACTED] me seli ne Prishtine, si e bazuar.

DETYROHET I padituri [REDACTED] nga Shtimja rr" [REDACTED] qe paditeses t'ia kompensoje shumen prej 1,465.00€, ne emer te rimbursimit te demit te shkaktuar ne aksidentin e trafikut te dates 13.08.2011 ne fsh.Firaj-Shterrpce, se bashku me kamatën e cila do te llogaritet sipas lartesisë qe aplikojne bankat per deponimet e rendomta te qytetareve per periudhe njevjecare, padestinin te caktuar, nga dita e ushtrimit te padise , dates 08.01.2013 e deri ne pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedures ne shumë prej 50.00€, te gjitha keto ne afat prej 15 ditësh, pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nen kercënimin e përmbarimit me dhunë.

OBLIGOHET paditesja qe te paguan taksën gjyqësore per padi dhe aktgjykim, ne shumë prej 50.00€, menjherë pas pranimit te këtij aktgjykimi, nen kercënimi e përmbarimit me forcë.

A r s y e t i m i

Paditesja, ne ketë gjykatë ka ushtruar padi kundër te paditurit, per rimbursimin e demeve te kompenzuara, per shkak te veprimeve te kundërligjshem te te paditurit, qe ka ndërmarr me rastin e shkaktimit te aksidentit ne komunikacionin rrugor.

Gjykatës i kanë bashkangjitur provat dhe dëshmitë tjera material per ndodhin ne aksident dhe per kompensimin e demeve, qe paditesja ka përmbushur ndaj te tretëve, per shkak te veprimeve deliktore te te paditurit, ne komunikacionin rrugor.

Gjykata, te paditurit, me datë 29.11.2014 i ka dorezuar padinë se bashku me provat e lëndës si dhe aktvendimin per pergjigje ne padinë e paditeses, por i padituri brenda afatit te percaktuar ligjor, me aktvendimin per dhënien e pergjigjes ne padi nuk ka ushtruar ne ketë gjykatë pergjigjen e tij nese e kundërshton apo jo kerkesepadinë e paditeses, ndërsa gjykata nga provat e ceshtjes ka gjetur se themelësia e kerkesepadisë del nga faktet e treguara ne padi dhe se faktet e tilla nuk janë ne kundërshtim me provat e propozuara nga paditesja, si dhe duke patur parasysh faktin se I padituri ka

pranuar me rregull padine me prova dhe aktvendimin per pergjigje ne padi, gjykata bazuar ne nenin 150.6 te LPK-së ka vendosur që të marrë aktgjykim kontumacional, pa dëgjimin e palëve ndërgjyqjese.

Gjykata nuk ka gjetur ndonjë rrethanë nga neni 150.2 te LPk-së, që përjashton mundësin për nxjerrjen e aktgjykimit të tillë, në rastin konkret.

Gjykata lidhur me kamaten ka vendosur ne bazë të nenit 277 te LMD-se, duke qenë se për paditësen lartësia e dëmit dhe shkaktuesi i saj, kanë qenë të përcaktuar që në kohën e ngritjes së padisë.

Gjykata ka obliguar të paditurin për kompensimin e shpenzimeve te procedures kontestimore ne baze te nenit 452.1 te LPK-se, ndërsa paditësen në bazë të UA nr.2008/2 te KGJK-se, per unifikimin e taksave gjyqesore.

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ

C.nr.17/13 date 19.02.2015

Gjyqtari,
Enes Mehmeti



Keshilla juridike: Kunder ketij aktgjykimi eshte e lejuar ankesa ne afat prej 15 ditesh ne gjykaten e Apelit ne Prishtine, permes kesaj gjykate. Afati fillon nga dita e neserme e pranimit te ketij aktgjykimi.

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVMOŠNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROŠEVAC,

02.04.2015

